

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7906
E martë, 15 tetor 2024
Çmimi 0.50 €

Muhamet Mavraj: Degradim pas degradimi

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

ADOLF HITLERI - JETA, MIZORITË
DHE VDEKJA E TIJ (1)

ÇFARË SIMBOLIZONTE SHPREHJA
GJERMANE "SHUMË ARMIQ,
SHUMË NDER"? F.6

Shkruan:
Prof. dr. Agim ZOGAJ



AKTUALE



LIDERËT E BALLKANIT PERËNDIMOR
NËNSHKRUAJNË MARRËVESHJE TË
REJA NË BERLIN F.5

MBI 7 000 MIJË KËRKESA PËR
REGJISTRIM PËR VOTIM JASHTË
VENDIT F.7


EKONOMI



BE-ja PRAN FINALIZIMIT TË MJETEVE
PËR BALLKANIN PERËNDIMOR F.8

ASK-ja: PAGAT MESATARE BRUTO NË
KOSOVË MË 2023 ISHIN 570 EURO F.8

SPORT



KOSOVA SONTE PËRBALLET ME
QIPRON, FODA DHE ZHEGROVA:
SYNOJMË FITORE F.10

OPOZITA E QUAN SHQETËSUES FURNIZIMIN ME USHQIM TË USHTARËVE TË FSK-së, KËRKON DORËHEQJEN E MAQEDONCIT,

FAQE 4-5



Deputetët e partive opozitare, pa praninë e deputetëve të mazhorancës, kanë mbajtur të hënën seancë të jashtëzakonshme, ku kanë debatuar për problemin e furnizimit me ushqim të ushtarëve

të FSK-së. Opozita e ka quajtur shqetësues problemin e furnizimit me ushqim të ushtarëve të FSK-së, duke kërkuar dorëheqjen e ministrit Maqedonci dhe hetim nga Prokuroria. Deputetët opozitarë

përmendën edhe probleme të tjera me të cilat thanë se përballet FSK-ja, sikurse është edhe paga e vogël për ushtarë, procesi i gradimit dhe largimi i ushtarëve për shkak të pagave të ulëta

Reagim i KMDLNj-së

PO SHKELET
SERIOZISHT
PARIMI I BARAZISË
PARA GJYKATËS
SPECIALE F.7



KURTI NË
SAMITIN E
BERLINIT KËRKON
QË KOSOVËS T'I
JEPET STATUSI I
KANDIDATIT
PËR BE F.3



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

BE-ja do të vendosë sanksione ndaj Iranit

BRUKSEL, 14 TETOR - Ministrat e Jashtëm të shteteve të Bashkimit Evropian takohen më 14 tetor për të debatuar lidhur me përshkallëzimin e konfliktit në Lindjen e Mesme dhe për përpjekjet e bllokut për të mbështetur Ukrainën, e cila po përballlet me pushtimin e nisur nga Rusia,

pavarësisht se për këtë çështje ka rezistencë nga Hungaria. BE-ja planifikon të godasë aktorët rusë dhe organizatat që akuzohen për destabilizimin e demokracisë së Moldavisë dhe sigurisë me sanksionet e reja para se Moldavia të mbajë një

referendum kyç më vonë gjatë këtij muaji për anëtarësim në bllok. Blloku po ashtu dëshiron të ndëshkojë Iranin për shkak të furnizimit të Rusisë me raketa balistike, të cilat Moskë i përdor kundër Ukrainës. Sanksionet e BE-së do të miratohen më 14 tetor dhe

ato do të shënjestrojnë kompani dhe individë të përfshirë në programin e raketave balistike të Iranit, dhe dërgimin e këtyre dhe armëve të tjera në Rusi. Rusia ka nisur pushtimin e paprovokuar të Ukrainës në shkurt të vitit 2022 dhe Bashkimi Evropian, së bashku



me shtete të tjera, ndihmojnë financiarisht dhe me pajisje ushtarake Kievin, me synim që të mposhtë forcat ruse.

Zelensky: Koreja e Veriut po dërgon ushtarë dhe armë në Rusi

KIEV, 14 TETOR - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky pretendoi se Koreja e Veriut ka dërguar ushtarë dhe armë në Rusi për ta mbështetur luftën e Moskës në Ukrainë. Mediet ukrainase së fundi kanë raportuar se gjashtë pjesëtarë të personelit ushtarak të Koresë së Veriut u vranë në një sulm ajror ukrainas në rajonin ukrainas të Donjeckut - të pushtuar nga Rusia më 3 tetor. Raportimet e medieve ukrainase nuk kanë mundur të verifikohen në mënyrë të pavarur, por gjatë adresimit të tij në orët e vona të 13 tetorit, Zelensky për herë të parë përsëriti këtë pretendim. "Kjo më nuk është çështje vetëm e transferimit të armëve. Tashmë ka të bëjë me transferimin e



njerëzve nga Koreja e Veriut për të forcat e ushtrisë okupuese", tha ai. Zelensky nuk ofroi dëshmi për të

mbështetur këtë pretendim, por spekulimi mbi rolin e Koresë së Veriut në konflikt është rritur në mesin e shenjave se Moskë po

forcon lidhjet me shtetet sikurse Koreja e Veriut dhe Irani, pas pothuajse 32 muajsh që kur Rusia nisi pushtimin në shkallë të plotë të Ukrainës. Instituti për Studim të Luftës, me seli në Uashington, së fundi ka raportuar se qindra trupa të Koresë së Veriut kanë arritur në Rusi dhe po përgatiten që të dislokohen në Ukrainë. Koreja e Veriut raportohet se i ka ofruar Moskës armë dhe municion, që Rusia i përdor kundër Ukrainës. Shërbimi i inteligjencës së Koresë së Jugut ka pretenduar se Pheniani e ka furnizuar Moskën me municione të artilerisë dhe raketa me rreze të shkurtrë veprimi. Kremlini ka hedhur poshtë këto pretendime, por nuk

ka komentuar lidhur me deklaratën e Zelenskyt. Zelensky tha se dislokimi vë në pah nevojën e Ukrainës për "më shumë mbështetje" nga partnerët e saj perëndimorë për të "rritur presionin ndaj Rusisë" dhe për të parandaluar "një luftë më të madhe". Presidenti ukrainas javën e kaluar vizitoi Britaninë, Gjermaninë, Francën dhe Italinë dhe u kërkoi partnerëve të Kievit që të vazhdojnë mbështetjen ushtarake për Kievin. Situata në Ukrainë dhe Lindjen e Mesme pritet të jetë në krye të agjendës gjatë takimit mes presidentit amerikan, Joe Biden, dhe udhëheqësit gjerman, Olaf Scholz, gjatë vizitës në Berlin më vonë gjatë javës.

Izraeli kryen sulm vdekjeprurës në një kamp në Gazë

DEIR AL-BALA, 14 TETOR - Një sulm ajror izraelit në oborrin e një spitali në Rripin e Gazës ka lënë të vranë të paktën katër persona dhe ka nxitur një zjarr që ka përfshirë një kamp me tenda ku strehohen personat e zhvendosur nga lufta. Dhjetëra persona kanë pësuar djegie të rënda, sipas mjekëve palestinezë. Ushtria izraelite tha se ka shënjestruar militantët që fshihen në mesin e civilëve, por nuk ofroi asnjë dëshmi për këtë pretendim. Në muajt e fundit, Izraeli vazhdimisht ka sulmuar strehimoret dhe kampet me tenda, duke pretenduar se ato përdoren nga luftëtarët e Hamasit - grupit palestinez të

shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian për të nisur sulme ndaj Izraelit. Në spitalin Martirët e Al-Aksës, në qytetin Deir al-Bala veçse ka një numër të madh të plagosurve, pasi më herët gjatë të hënës Izraeli sulmoi një shkollë, ku strehohen palestinezët e zhvendosur, duke vranë të paktën 20 persona. Disa shpërthime janë dëgjuar pas sulmit izraelit, megjithatë ende është e paqartë nëse shpërthimet u shkaktuan nga armët apo nga shpërthimi i depozitave të karburanteve. Sipas të dhënave të spitalit, katër persona u vranë dhe 40 të tjerë u plagosën gjatë sulmit



ajror izraelit në kampin me palestinezët e zhvendosur. Njëzet e pesë persona janë transferuar në spitalin Naser në jug të Gazës, pasi kanë pësuar

djegje të rënda, tha spitali Martirët e Al-Aksës. Izraeli po vazhdon të kryejë përditë sulme në mbarë Rripin e Gazës, teksa lufta ka nisur mbi


një vit më parë. Lufta nisi pasi Hamasi sulmoi jugun e Izraelit më 7 tetor 2023, duke vranë afër 1.200 persona, shumica civilë dhe duke rrëmbyer afër 250 të tjerë. Edhe afër 100 persona ende mbahen brenda Gazës, teksa një e treta e tyre besohet se kanë vdekur. Si pasojë e ofensivës hakmarrëse të Izraelit, në Gazë janë vranë më shumë se 42.000 palestinezë, sipas Ministrisë së Shëndetësisë në Gazë. Sipas kësaj ministrie, mbi gjysma e viktimave ishin gra dhe fëmijë. Rreth 90 për qind e popullsisë së Gazës prej 2.3 milionë banorësh janë zhvendosur si pasojë e luftës, shpesh disa herë.

Seuli thotë se Koreja e Veriut po përgatitet të shkatërrojë rrugë kufitare

SEULLI, 14 TETOR - Koreja e Jugut tha se ka vërejtur shenja se Koreja e Veriut po përgatitet të shkatërrojë rrugë në pjesën veriore, që lidhin dy Koretë, e të cilat nuk përdoren më, teksa janë rritur tensionet mes dy shteteve, pas pretendimeve të Koresë së Veriut se Jugu ka fluturuar dronë mbi territorin e saj. Shkatërrimi i rrugëve do të ishte në linjë me përpjekjet e

liderit verikorean, Kim Jong Un, për të shkëputur raportet me Korenë e Jugut dhe për ta çimentuar atë zyrtarisht si armiken kryesore dhe për të hequr dorë nga synimi i kamotshëm i bashkimit paqësor të dy Koreve. Ushtria e Koresë së Jugut tha më 14 tetor se ka vëzhguar disa aktivitete në Korenë e Veriut që duket se janë përgatitje për shkatërrimin e rrugëve,

aktivitete sikurse është instalimi i ekraneve. "Ata po i instalojnë këto ekrane në rrugë dhe po punojnë pas këtyre ekraneve, duke u përgatitur që të hedhin në ajër këto rrugë", tha zëdhënësi i Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë jugkoreane, Lee Sung Joon. Ai tha se shkatërrimi i rrugëve mund të ndodhë edhe në ditët në vazhdim.



Muhamet Mavraj: Degradim pas degradimi

PRISHTINË, 14 TETOR - Publicisti Muhamet Mavraj, pas zhvillimeve në vend, sidomos pas situatës së fundit të furnizimit me ushqim për ushtarët e FSK-së, ka theksuar se vendi po shkon nga degradimi në degradim.

Ai në "Facebook" ka kritikuar qeverinë aktuale, duke ia përkujtuar se e mori pushtetin me shumë të arritura, me një shkallë supreme të besimit të ndërsjellë tek aleatët, ndërkaq sot thotë se nuk ka përparim asnjë milimetër. "Pas arritjes së lirisë nuk u zhduk rrënja as fryma e Ushtrisë Çlirimtare, por u transformua në tre drejtime: Polici (ShPK), Trupa Mbrojtëse (TMK) dhe politike (kryesisht PDK). Që të tri këto trashëgimi të çlirimtarëve, bashkë me menderakët shtetformues tradicionalë jetësuan shtetin e pavarur të Republikës së Kosovës dhe e dorëzuan te klubi i stanit me 117 njohje ndërkombëtare në tërësinë territoriale, me prestigj simpatik ndërkombëtar, anëtarë në disa organizata universale dhe rajonale. Lanë një përvojë solide në diplomaci e inteligjencë dhe shkallë supreme të besimit të ndërsjellë tek aleatët. Të gjitha këto drejtime shtetërore dhe të

arritura të tyre, trashëgimia shtetndërtuese e tyre, nuk u përparuan më tej për asnjë milimetër", ka shkruar Mavraj, duke shtuar se u degraduan rëndë për një mandat qeverisës deri në sanksione të rënda për kurrizin e këtij shteti të vogël dhe talljen e rëndë me ushtrinë: "s'ka bukë për ushtrinë e shtetit!", ka shkruar Mavraj.

Postimi i plotë i Mavrajt:

Pas arritjes së lirisë nuk u zhduk rrënja as fryma e Ushtrisë Çlirimtare, por u transformua në tre drejtime: Polici (ShPK), Trupa Mbrojtëse (TMK) dhe politike (kryesisht PDK).

Kushdo që të paktën një minutë në jetën e tij nuk e ka pasur në zemër Ushtrinë Çlirimtare, por një dashuri krejt tjetër përballë saj, tërë jetën do ta shpenzojë në përbuzje e urrejtje të këtyre tri drejtimeve, haptas e fshehtas. Që të tri këto trashëgimi të çlirimtarëve, bashkë me menderakët shtetformues tradicionalë, jetësuan shtetin e pavarur të Republikës së Kosovës dhe e dorëzuan te klubi i stanit me 117 njohje ndërkombëtare në



tërësinë territoriale, me prestigj simpatik ndërkombëtar, anëtarë në disa organizata universale dhe rajonale. Lanë një përvojë solide në diplomaci e inteligjencë dhe shkallë supreme të besimit të ndërsjellë tek aleatët. Të gjitha këto drejtime shtetërore dhe të arriturat e tyre,

trashëgimia shtetndërtuese e tyre, nuk u përparuan më tej për asnjë milimetër. Përkundrazi: fillimisht ngecën, ndërsa u degraduan rëndë për një mandat qeverisës deri në sanksione të rënda për kurrizin e këtij shteti të vogël dhe në talljen e rëndë me ushtrinë: s'ka bukë për ushtrinë e

shtetit!
U bëmë gazi alem, e padëgjuar ndër ushtritë e botës!
Por, për Ju miqtë e mi, kjo nuk është aspak për befasi, siç ju kujtohen qëndrimet e shprehura në këto pesë vjet, këtu dhe në mediet e tjera. Ai stan atë bulmet ka.

REAGIM I KMDLNJ-së

Po shkelet seriozisht parimi i barazisë para Gjykatës Speciale

Në kohën kur Prokuroria Speciale në Hagë, e kritikuar shkaku i zvarritjes së procesit ngase ishte vonuar me thuaja të gjitha propozimet që mbështesin akuzën, mori vendim që të heqë dorë nga dëshmia para gjykatë të disa dëshmitarëve, KMDLNj pati reaguar publikisht që të mos dëmtohen të akuzuarit duke ua larguar dëshmitarët që paraqesin interes për të akuzuarit. Pikërisht kjo edhe ndodhi pasi për këtë reagoi mbrojtja e presidentit Hashim Thaçi duke bërë publik faktin se Prokuroria Speciale në Hagë ka hequr dorë nga dëgjimi para Gjykatës Speciale të dy dëshmitarëve që paraqesin interes të jashtëzakonshëm për mbrojtjen. Nëse Gjykata Speciale e miraton propozimin e Dhomave



të Specializuara për mosthiritjen e këtyre dëshmitarëve, atëherë, pa asnjë dyshim shkel parimin e barazisë së palëve në procedurë duke e pakësuar mbrojtjen efektive e që garantohet me të gjitha dokumentet kombëtare dhe ndërkombëtare për të drejtat

e njeriut të personave të privuar nga liria duke pamundësuar një proces gjyqësor të drejtë, të paanshëm dhe të pandikuar nga politika dhe grupet e interesit. Pasi kemi të bëjmë me një shkelje të rëndë të barazisë së palëve në procedurë, reagimi duhet të jetë i

fuqishëm, si nga institucionet kosovare ashtu edhe nga organizatat apo institucionet monitoruese sikur që është Ombudpersoni i Holandës dhe Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq sikur edhe nga Komiteti për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Degradues i Kombeve të Bashkuara. Dhomat e Specializuara nuk kanë të drejtë që dëshmitarët t'i trajtojnë sipas standardeve të dyfishta; ata që paraqesin interes për këto dhoma t'i merr në pyetje sa të duan kurse ata që paraqesin interes për mbrojtjen, të mos ftohen fare. Gjykata Speciale nuk duhet të lejojë këtë, ndryshe do të identifikohet si shkelëse e të drejtave të njeriut të personave të privuar nga liria dhe seriozisht do

të vë në dyshim besimin në këtë gjykatë si dhe vendimet që i merr. KMDLNj thekson se institucionet e Kosovës përkatësisht Ministria e Drejtësisë duhet të reagojnë për shkelje të barazisë së palëve në procedurë dhe se ky reagim në asnjë rast dhe rrethanë nuk mund të merret si ndërhyrje në punën e Gjykatës Speciale në Hagë. Edhe të akuzuarit duhet ta kundërshtojnë këtë propozim të Dhomave të Specializuara aq më parë që Prokuroria Speciale, dëshmitarët që i ka konsideruar të rëndësishëm për mbështetje të aktakuzës i ka konsumuar më herët. Me shkeljen e barazisë së palëve në procedurë po shkelet brutalisht edhe parimi i prezumimit të pafajësisë.

Rama: Nuk ka marrëveshje me vende të tjera përveç Italisë për emigrantët

Tiranë, 14 tetor - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në prag të hapjes së kampit në Gjadër, në një intervistë për "Reuters" hodhi poshtë çdo mundësi për një marrëveshje me një shtet tjetër të BE-së përveç Italisë për pritjen e emigrantëve. Rama ka thënë për median e huaj se Shqipëria ka bërë një marrëveshje me Italinë për t'ò pranuar refugjatët që mbërrijnë atje për të ndihmuar në frenimin e migracionit të parregullt në BE.

I pyetur nëse një marrëveshje e tillë ishte e mundur edhe me Gjermaninë, ai tha se aktualisht nuk ka kapacitet të mjaftueshëm. "Gjermania duhet të gjejë një partner tjetër", ka thënë Rama.

Kryeministri e ka bërë të qartë se synon të kandidojë për një mandat të katërt në 2025. "Plani është të kandidojmë. Unë besoj se duhet të kandidoj sepse ka punë për të përfunduar. Në këto tre mandate, ne kemi bërë gjëra të mahnitshme. Shqipëria ishte



vetëm një lajm i keq kur bëhej fjalë për lajme, por tani kemi kapërcyer tavanin e 10 milionë turistëve në një vend ku turizmi

ishte një ide e mirë, por nuk ishte bërë ende realitet. Ka ende shumë gjëra për t'u bërë, siç është lufta kundër korrupsionit që duhet të jetë një luftë e pakthyeshme", është shprehur ai.

Rama merr pjesë sot në Procesin e Berlinit, me liderët e Ballkanit Perëndimor dhe përfaqësues të BE, ndërsa Shqipëria kërkon anëtarësimin në Bashkimin Evropian 2030-n. "Një marrëveshje e zgjeruar e Tregtisë së Lirë të Evropës

Qendrore (CEFTA) për rajonin e Ballkanit Perëndimor është e arritshme. Do të jetë e rëndësishme të... rregullojmë mekanizmin e CEFTA-s", tha ai në intervistë përpara samitit të organizuar nga kancelari gjerman Olaf Scholz. Scholz do të bisedojë me Shqipërinë, Bosnjën, Kosovën, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë në negociatat që u nisën më 2014 me synimin për ta integruar rajonin në politika më të përputhshme me BE-në.



Opozita e quan shqetësues furnizimin me ushqim të ushtarëve të FSK-së, kërkon dorëheqjen e Maqedonci

Deputetët e partive opozitare, pa praninë e deputetëve të mazhorancës, kanë mbajtur të hënën seancë të jashtëzakonshme, ku kanë debatuar për problemin e furnizimit me ushqim të ushtarëve të FSK-së. Opozita e ka quajtur shqetësues problemin e furnizimit me ushqim të ushtarëve të FSK-së, duke kërkuar dorëheqjen e ministrit Maqedonci dhe hetim nga Prokuroria. Deputetët opozitarë përmendën edhe probleme të tjera me të cilat thanë se përballet FSK-ja, sikurse është edhe paga e vogël për ushtarë, procesi i gradimit dhe largimi i ushtarëve për shkak të pagave të ulëta

Haradinaj. Deputeti i AAK-së, Bekë Berisha, në fjalën e tij ka thënë se situata aktuale është tepër shqetësuese. "Trajtimi i ushtarëve tanë me neglizhencë është një shkelje e përgjegjësive të kësaj qeverie. Kriza e furnizimit me produkte esenciale për FSK-në është sinjal alarmant që kërkon një zgjidhje të shpejtë", ka pohuar ai. Berisha ka thënë se ushtarët s'duhet të shqetësohen se a kanë ushqim apo çfarë kualiteti është ushqimi i tyre. "Ata duhet të jenë të preokupuar vetëm me pjesën e detyrave që i kanë", ka thënë ai, duke e akuzuar qeverinë për "sabotim të qëllimshëm të një institucioni kyç për stabilitetin e vendit". Ai ka theksuar se për ta kthyer dinjitetin sot ish dashur të ketë zgjidhje kjo çështje, të ndodhë dorëheqja e ministrit, zëvendësministrit dhe sekretarit të zgjedhur jashtëligjshëm, si dhe hetim nga Prokuroria. Deputetë të tjerë përmendën edhe probleme të tjera me të cilat thanë se përballet FSK-ja, sikurse është edhe paga e vogël për ushtarë, procesi i gradimit dhe largimi i ushtarëve për shkak të pagave të ulëta. Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Hisen Berisha, ka thënë se çështja e shujtave të FSK-së po e rrezikon shëndetin e qytetarëve,

por edhe operacionalitetin e FSK-së. "Çështja e ushqimit të ushtarëve të FSK-së është një sinjal i qartë i problemeve të menaxhimit dhe mungesës së përgatitjes afatgjatë. Tani e kanë kuptuar [Qeveria] se ashtu siç nuk ishte i aplikueshëm koncepti i shërbimit të detyrueshëm ushtarak, edhe ideja për ngritjen e kapaciteteve për vetëqëndrueshmëri në ushqim në forcë është një ide që do ta komprometojë forcën", ka theksuar ai. Anton Quni nga Lidhja Demokratike e Kosovës ka deklaruar se Ministria e Mbrojtjes është përgjegjëse që ta sigurojë mirëqenien e ushtarëve dhe ta tregojë kujdesin dhe përkushtimin më të lartë për t'i siguruar kushtet e përshtatshme për operimin e mbarëvajtjen e të gjitha proceseve për ushtarët. "Ministria e Mbrojtjes duhet të sigurojë që proceset e prokurimit për FSK-në të jenë në përputhje me parimet dhe standardet më të larta të transparencës, konkurrencës së drejtë dhe standardet e NATO-s", ka thënë ai. Quni ka shtuar se sipas standardeve të vendeve të NATO-s është "absolutisht e papranueshme që një procedurë sikurse ajo e ushqimit për ushtrinë të shpërfaqë shkelje

elementare, ku procedurat e tilla fillimisht si sekrete e më pas si procedurë emergjente janë shpallur në kundërshtim të plotë me legjislacionin". Ai ka thënë se sipas Ligjit për Prokurim Publik, vetëm në raste të caktuara mund të ketë kontrata emergjente, duke thënë se Ministria e Mbrojtjes nuk ka arritur ta planifikojë përfundimin e kontratës për ushqim në mënyrë të duhur dhe me operatorin e mëparshëm. Teksa deputetët ishin duke e vazhduar debatin dhe akuzat ndaj qeverisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes, kjo e fundit reagoi përmes një postimi në "Facebook", duke sqaruar se ministri Ejup Maqedonci nuk ka refuzuar të nënshkruajë kontratë me operatorin e ri ekonomik për ushqim për FSK-në. Ministria e Mbrojtjes ka njoftuar se tenderi për furnizim me ushqim për FSK-në është anuluar për shkak se ka kontest mes grupit të operatorëve ekonomikë që janë shpallur fitues. Ministria ka theksuar se koncepti i vetëqëndrueshmërisë është opsioni më i mirë për zgjidhjen e problemit të ushqimit. "Mosvazhdimi i kontratës me operatorin e deritanishëm s'do të thotë paralizim i ofrimit të këtij shërbimi", u tha në reagim. Ministria tha se aktualisht në çdo

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 14 TETOR - Me kërkesën e deputetëve të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe përkrahjes nga deputetët e dy partive të tjera opozitare, PDK-së dhe LDK-së, të hënën është debatuar për çështjen e furnizimit me ushqim të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK). Kryetari i partisë opozitare, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, e ka akuzuar kryeministrin Albin Kurti se "po e lë ushtrinë pa bukë". "Sot po trajtojmë situatën me logjistikën, shërbimet. Merreni me mend,

jemi mbledhur gjashtë vjet pasi u krijua ushtria, dhe jemi kthyer po flasin për logjistikën. Ushitari i Kosovës nuk ka shkuar atje [në ushtri] për ushqimin e tij, për ato kushte, për pagën. Ai është në gjendje me dhanë racionin e vet ditor për secilin qytetar. Ai ka shkuar për të shërbyer deri në frymën e fundit të jetës së vet", ka thënë Haradinaj, duke e quajtur Kurtin spiun të Serbisë. "Po, është spiun i Serbisë, është tradhtar ai që e lë ushtrinë e vet pa bukë. Pse e bën këtë? Pse po i ndodh këtij? Pse jo dikujt tjetër gjatë krejt ekzistencës që 20 vjet. Edhe kjo rastësi, pahiri. I ka lanë pa veshmbathje, mbërrini me lanë edhe pa bukë", ka deklaruar

Kurti në Samitin e Berlinit kërkon që Kosovës t'i jepet statusi i kandidatit për BE

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

BERLIN, 14 TETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në samitin e Procesit të Berlinit, ka kërkuar që Kosovës t'i jepet statusi i kandidatit për BE. "Pas dy muajsh do të shënojmë dy vjet prej kur Kosova ka aplikuar për anëtarësim në BE. Ndërsa ne deklarojmë se zgjerimi është përsëri në agjendë, ka ardhur koha që Kosova ta marrë statusin zyrtar të kandidatit. Në këto tre vite e gjysmë të fundit kemi shënuar rritje të jashtëzakonshme ekonomike, progres demokratik dhe stabilitet institucional, duke menaxhuar suksesshëm disa kërcënime serioze të sigurisë. Njohja e përpimit dhe të arriturave të Kosovës, po ashtu, afirmon përkushtimin e BE-së ndaj zgjerimit dhe vlerave të saj", tha Kurti.

Kurti shtoi se, nisur nga 1 janari i vitit të ardhshëm, Kosova, njëanshëm, do ta lejojë lëvizjen e lirë për të gjithë poseduesit e letërnjoftimeve të Bosnjë-Hercegovinës. Përkundër marrëveshjeve të arritura, qytetarët e të dyja vendeve aktualisht duhet të pajisen me viza për të lëvizur në vendet respektive.

Duke folur në samitin e Procesit të Berlinit, që po mbahet në kryeqytetin gjerman, Kurti tha se ky projekt ka sjellë përpim të rëndësishëm deri më tash, por se duhen "edhe më shumë veprime". "Ndërsa entiteti i Republikës Sërpska refuzon ratifikimin e marrëveshjes për lëvizje të lirë me letërnjoftime - të cilën vendi im ka qenë i pari në rajon që e ka ratifikuar në Parlament - unë kam vendosur t'i jap fund pritjes. Duke filluar nga 1 janari i vitit të ardhshëm, Republika e Kosovës, në mënyrë të njëanshme, do ta lejojë lëvizjen e lirë për mbajtësit e letërnjoftimeve të Bosnjë-Hercegovinës", tha Kurti, duke shtuar se lidhshmëria është thelbësore për Procesin e Berlinit.

I lansuar në vitin 2014 nga kancelarja e atëhershme gjermane, Angela Merkel, ky proces shënon sivjet dhjetë vjet. Synimi i samiteve të tij, të cilat mbahen çdo vit, është ta rritin bashkëpunimin mes vendeve të Ballkanit Perëndimor - Kosovës, Shqipërisë, Serbisë, Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut - dhe gradualisht t'i afrojnë ato më pranë BE-së.

Nga gjashtë shtetet e rajonit, vetëm Kosova nuk është kandidate zyrtare për anëtarësim në BE.

Në kuadër të Procesit të Berlinit,



Kurti pritet nga Scholzi

Në nisje të Samitit të Berlinit kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, është pritur nga

kancelari gjerman, Olaf Scholz, në Berlin të Gjermanisë. "10-vjetori i Procesit të Berlinit vendtakim e ka pikërisht kryeqendrën e Gjermanisë. Një dekadë vullnet, punë e angazhim për ta afruar rajonin tonë më shumë drejt BE-së", ka

shkruar Kurti në "Facebook" në një fotografi që ka publikuar me kancelarin gjerman. Kurti ka shtuar se Berlini është vendi dhe tash është momenti për më shumë progres e për ta bërë këtë samit jubilar të suksesshëm.

ndër vite, janë bërë disa marrëveshje dhe deklarata, por shumë prej tyre kanë mbetur pa u zbatuar.

Marrëveshja për lëvizje të lirë me letërnjoftime mes vendeve të Ballkanit Perëndimor është arritur në vitin 2022.

Derisa qytetarët e Kosovës mund të lëvizin me letërnjoftime në Maqedoni të Veriut, Shqipëri, Serbi dhe Mal të Zi, ata duhet të pajisen me viza për të shkuar në Bosnjë-Hercegovinë. Ngjashëm, edhe ata të Bosnjës që duan të hyjnë në Kosovë, kjo për faktin se Bosnjë-Hercegovina, e cila nuk e njeh shtetin e Kosovës, nuk e ka ratifikuar ende marrëveshjen për lëvizje të lirë.

Gjatë samitit, Kurti foli edhe për Agjendën e Gjellbër në Ballkanin Perëndimor.

Ai kujtoi se Strategjia e Kosovës përfshin qëllimin për të kaluar në burime të rinovueshme të energjisë deri në vitin 2050. "Ndërsa kemi rezervën e pestë më të madhe të linjtit në botë, ne kemi vendosur objektiva të qarta për t'i reduktuar emetimet tona të gazeve serë në mbarë vendin - për 36 % deri në vitin 2030 - dhe për t'i mbajtur rezervat nën tokë. Ne mbetemi të

përkushtuar ndaj tranzicionit të gjelbër, edhe pse nuk jemi palë në Marrëveshjen e Parisit [për klimën]", tha Kurti. "Pavarësisht përpjekjeve tona, ne jemi ende të përgjatur nga mekanizmat kryesorë shumëpalësh të financimit", tha ai, duke shtuar se Kosova ka nevojë për qasje në financat globale të klimës, që do ta mbështesnin tranzicionin e saj.

Duke folur në hapje të ngjarjes në Berlin, kancelari gjerman Olaf Scholz tha se Procesi i Berlinit "është instrumenti më i mirë jo vetëm për bashkëpunimin rajonal,

por edhe për përsheptimin e integritimit evropian të të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor". "Bashkimi Evropian është i kompletuar me Ballkanin Perëndimor si pjesë të tijën", tha ai. Scholz paralajmëroi nënshkrimin e dy dokumenteve të reja në samitin e sotëm që, siç tha, do ta bëjnë jetën e njerëzve më të lehtë. I pari, sipas tij, ka të bëjë me një plan të ri veprimi për tregun e përbashkët rajonal, ndërsa i dyti me një marrëveshje të re për lëvizjen, që përfshin edhe qasjen në arsimin e lartë.



Scholz, po ashtu, u bëri thirrje Kosovës dhe Serbisë që të angazhohen më aktivisht në normalizimin e marrëdhënieve mes tyre, duke u zotuar se do të punojë edhe personalisht me të dyja vendet. "Na duhet një dinamikë e re... do t'u thosha miqve nga Beogradi dhe Prishtina sot: Ju lutem mos lejoni që e kaluar t'ju frenojë në rrugën drejt një të ardhmeje paqësore dhe prosperuese. Jam i bindur se kjo e ardhme gjendet në BE dhe ekziston vetëm një rrugë që çon atje: zbatimi i plotë i marrëveshjeve të arritura", tha Scholz gjatë fjalës hyrëse. "Unë do të vazhdoj të angazhohem personalisht me të dyja vendet, për t'u siguruar se ato e shfrytëzojnë këtë mundësi", shtoi ai.

Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, tha se në 10-vjetorin e Procesit të Berlinit, "është mirë të jemi në Berlin me partnerët tanë nga Ballkani Perëndimor". "T'i shikojmë arritjet tona në të kaluarën, por le të shohim sidomos përpara. Drejt një të ardhmeje ku të gjashtë partnerët e Ballkanit Perëndimor janë pjesë e Unionit tonë", shkroi von der Leyen në platformën X.

Liderët e Ballkanit Perëndimor nënshkruajnë marrëveshje të reja në Berlin

Kryeministrat e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor nënshkruan në samitin e Procesit të Berlinit një plan të ri për tregun e përbashkët rajonal, si dhe një marrëveshje të re për lëvizshmërinë, e cila përfshin qasjen në arsimin e lartë.

Nën udhëheqjen e kancelarit gjerman, Olaf Scholz, samiti u mbajt në hënën në Berlin. Të pranishëm ishin edhe presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, dhe përfaqësues të vendeve partnere.

Scholz tha se marrëveshjet e reja "do ta bëjnë jetën e njerëzve më të lehtë". E para është pjesë integrale e Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor, i cili është miratuar nga Bashkimi Evropian në muajin maj dhe ka vlerën e gjashtë miliardë eurove.

Sipas një përlloraritje jozyrtare, Kosova do të mund të përfitojë mbi 880 milionë euro nga Plani i Rritjes. Mbi 250 milionë euro, asaj do t'i ndaheshin si para pa kthim, ndërsa pjesa tjetër në formën e kredive të volitshme.

kazermë janë të angazhuar kuzhinierët e Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Qendrës Studentore, por po ashtu më 10 tetor ka hapur konkursin për pranimin e stafit profesional të kuzhinierëve. "Me pranimin e personelit prej 106 personash kjo problematikë do t'i përkasë së kaluarës. Pa kosto të madhe financiare ushtrisë do t'i servohet vetëm ushqim cilësor", u tha në reagim.

Në javët e fundit mediet lokale

kanë publikuar shpesh fotografi të shujtave të ushtarëve, si dhe ankesave të pjesëtarëve të FSK-së për ushqimin që u servohet. Më herët, Ministria e Mbrojtjes e Kosovës ka thënë se të gjitha kazernat e FSK-së janë funksionale dhe se në to shërbehet llojllojshmëri shujtash, ndërsa raportimet në media i ka quajtur propagandë.

Pak para nisjes së seancës, partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, tha se nuk do të marrë pjesë në

seancën e së hënës, e as në nisja të tjera të partive opozitare.

Gjatë një konference për medie, deputeti i LV-së, Enver Dugolli, akuzoi opozitën se po e "shantazhon" grupin parlamentar të tyre, duke kushtëzuar pjesëmarrjen në seanca plenare dhe votimin e marrëveshjeve ndërkombëtare me shkarkimin e Mimoza Kusari-Lilës nga posti i kryetares së grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje. "S'pranojmë

kushtëzime të tilla", tha ai. "Si rrjedhojë, ne nuk marrim pjesë në asnjë lloj seance apo iniciative që vjen nga ana e tyre derisa ata nuk reflektojnë dhe shmangin këtë formë imponimi, që gjithsesi nuk kalon", shtoi ai. Ai foli edhe për seancën e jashtëzakonshme të thirrur lidhur me mungesën e ushqimeve në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Sipas Dugollit, për këtë gjë, ka raportuar në Komisionin për Çështje të Sigurisë edhe ministri i Mbrojtjes,

Ejup Maqedonci. Ai tha se LV-ja përkrahu kërkesën e opozitës për një raportim të tillë.

Kërkesa për seancë të jashtëzakonshme, sipas tij, është pjesë e një "seri dezinformatash që synojnë tash e disa ditë që t'i keqinformojnë qytetarët". Ndërkaq, deputeti tjetër i LV-së, Mefail Bajqinovci, akuzoi opozitën se po bën "propagandë" dhe po "dezinformon" sa i përket çështjes së shujtave të ushtarëve të FSK-së.

ADOLF HITLERI - JETA, MIZORITË DHE VDEKJA E TIJ (1)

Çfarë simbolizonte shprehja gjermane “shumë armiq, shumë nder”?

Edhe në fillim të shekullit XXI vazhdojnë të jenë të hapura pyetje të ndryshme lidhur me rrethanat shoqërore, historike, politike, kulturore, psikologjike etj. të paraqitjes së Adolf Hitlerit në skenën botërore. Në këtë kuptim, me të drejtë shtrohen pyetjet: Cila ishte parahistoria e paraqitjes së Adolf Hitlerit në skenën politike? Cilat ishin parakushtet historike, kulturore etj. që mundësuan paraqitjen e nazizmit si ideologji dhe lëvizje politike dhe ushtarake? Çfarë lloj njeriu mund të planifikonte dhe të zbatonte plane dhe projekte aq vdekjeprurës për njerëzimin? Megjithatë, Adolf Hitlerit, diktatorit më të rrezikshëm të shekullit të XX, nuk i dihet varri, ndërsa në vendin e tij në Gjermani nuk ka përmendore!



Shkruan:
Prof. dr. Agim ZOGAJ

Ambicjet diktatoriale

Shekulli XX kishte diktatorë të ndryshëm, ndërsa Adolf Hitleri ishte një nga ata që i solli më së shumti vdekje njerëzimit. Të dhënat flasin se mbi 50 milionë njerëz u vranë gjatë Luftës së Dytë Botërore të cilën e shkaktoi, e nxiti politika agresive, gjakatare e Adolf Hitlerit, politikë dhe projekt i cili në histori njihet me emrin nazizëm. Sot, kur mbarë bota shënon 60-vjetorin e përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Hitleri mbetet një figurë që frymëzon zemërimin dhe urrejtjen e miliona njerëzve. Njerëzit e rinj në moshë ndoshta nuk e dinë saktësisht se kush ishte ai ose çfarë krimesh të tmerrshme ka kryer. Por prindërit, gjyshërit dhe stërgjyshërit, me siguri që i mbajnë mend ato krime, ato luftëra dhe ato vuajtje. Veprimet kriminale të Hitlerit, në një mënyrë ose në një tjetër, kanë lënë gjurmë të thella te njerëzit që jetuan në vitet e vona të dy të tretave të fundshekullit të njëzetë. Sigurisht që Adolf Hitleri nuk ishte i pari lider i cili ishte një diktator, një lider me pushtet dhe autoritet absolut mbi njerëzit që drejtonte. Historia flet se ideja e diktaturës hodhi rrënjë më shumë se 2000 vjet më parë, në Romën e lashtë, ku gjenerali Jul Çezari e quajti veten e tij “Diktator deri në vdekje”. Vite dhe shekujt kaluan por, koncepti i një udhëheqësi

të plotfuqishëm nuk vdiq. Madje, në rrethanat e historisë moderne, kur u krijuan kushte dhe rrethanat të reja për lindjen e diktatorëve të llojit të ri, nga Evropa në Azi dhe në Amerikën Latine, filluan të dilnin liderë si Hitleri, që deklaronte se mund të zgjidhnin të gjitha problemet e kombit të tyre në qoftë se do t'u jepej pushteti për ta bërë këtë.

Në fakt, në shumicën e rasteve, influenca e diktatorëve të rinj nuk u përhap përtej kufijve të vendeve të tyre. Por disa prej tyre ushqyen ambicie më të mëdha. Në Itali, Benito Mussolini përfytyronte një “Perandori Romake” të re. Në Rusi, Vladimir Iliç Lenini dhe Josif Stalini u përpoqën të ndërtonin një shoqëri komuniste që do të shërbente si fillimi i një revolucioni mbarë botëror. Por, më i rrezikshmi nga diktatorët e shekullit të njëzetë, ishte Adolf Hitleri, të cilin, për çudi, në disa segmente veprimi diktatorial u përpoq ta imitonte Slobodan Milosheviqi, diktatori i fundit i shekullit të kaluar.

Sidoqoftë, me të drejtë shtrohet pyetja: Cila ishte parahistoria e paraqitjes së Adolf Hitlerit në skenën politike, përkatësisht cilat ishin parakushtet historike dhe të tjera që mundësuan nazizimin si ideologji dhe si lëvizje politike e ushtarake. Çfarë lloj njeriu mund të planifikonte dhe të vinte në zbatim plane kaq të tmerrshme. Si arriti të fitonte mbështetje për ndërmarrjet e tij vdekjeprurëse?

Në shekullin XIX dinastitë mbretërore ishin të mendimit, në përgjithësi, se kishin origjinë gjermanike. Heinrich Heine, me krenari deklaronte se: “Mbretërit tanë janë vendosur në të gjitha fronet e Evropës”. Madje një mistik anonim i shekullit XII kishte shkruar aq larg sa që kishte pohuar se Adami dhe Eva flisnin

gjermanisht. Kjo donte të thoshte se, ndryshe nga gjuhët romane, gjuha gjermane, që në origjinë, ishte krejt e ndryshme dhe një e vetme, pa degëzime, pra një gjuhë origjinale e njerëzimit. Humanistët e parë gjermanë madje, shkruan studime ku mbështetnin arsyen dhe të drejtën e hegemonisë së Perandorisë së Shenjtë gjermanike ose të gjermanizimit. Ekzistojnë, po ashtu, edhe shkrime që duket sikur paralajmëronin ardhjen e Reichut të III, sepse në to jepeshin këshilla se si të ktheheshin në skllëvër romakët, sllavët dhe çifutët.

Hitleri kishte një gjen shkatërrimtar

Kështu, nga brezi në brez, mund nxirren shprehjet që u përdorën, nga autorë para së gjithash, për ti thurur lavdi gjuhës gjermane, ashtu edhe për tu përkujdesur për “pastrimin” e saj, siç ndodhi në shekullin XVII. Në mënyrë të veçantë Montesquieu u thurte lavdi virtyteve, siç shprehej, të “baballarëve tanë gjerman”. I famshmi Fichte ndërkaq i cili i ndau popujt e Evropës në “gjermanë” dhe “neolatinë”, deklaronte se ndeshja e tyre do të vendoste fatet e botës. Fichte shkruante: “Po të shkatërroheshin ju, i tërë njerëzimi do të shkatërrohet bashkë me ju, pa asnjë shpresë rimëkëmbje”.

Në vitin 1871, pas mbarimit të

luftës franko - prusiane, bashkimi i Gjermanisë bëri tjetër veçse forcoi krenarinë kombëtare dhe raciale.

Ishte më vonë, biologu anglo - gjerman Houston Stewart Chamberlain që u bë profet i arianizmit. Ai në veprën e tij prej 1500 faqesh “Gjeneza e shekullit XIX”, pohonte se vetëm arianët ishin me të vërtetë krijues dhe se i gjithë përparimi i mendjes njerëzore u dedikoej atyre.

Rezultatet e përfundimit të Luftës së Parë Botërore dhe disfata e Gjermanisë në të, shkaktoi paqartësi të reja në radhët e elitës së kombit gjerman. Elita gjermane, për disfatën e Gjermanisë në këtë luftë fajësoi pjesën më të madhe të kombeve të ashtuquajtura të qytetëruara të kohës. Ndaj, ndër patriotët gjerman të kohës, ishte në modë shprehja “Shumë armiq, shumë nder”.

I gjithë kombi ishte kundër Marrëveshjes së Versajës, të cilën e konsideronte si burim i të gjitha fatkeqësive të popullit gjerman.

Adolf Hitleri ka lindur më 20 prill të vitit 1889, në qytetin e vogël austriak të quajtur Braunau, në kufirin mes Austrisë dhe Gjermanisë. Ishte fëmija i katërt i prindërve të tij dhe i pari që jetoi mbi moshën dy vjeç.

Familja Hitler bënte një jetë të rehatshme si klasë e mesme. Babai i Adolfit, Alois, ishte një oficer i respektuar dogane,

nëna e tij Klara ndërsa, kishte qenë dikur shërbëtoreshë dhe njëhej si grua e thjeshtë, modeste dhe e sjellshme. Në vitin 1903, Hitlerit i vdiq i ati duke i lënë familjes një pasuri të vogël. Nga babai u edukua në një mënyrë të ashpër që të bëhej i fortë dhe ky i mbajti mëri gjithë jetën. Ndërsa nënën duket se e adhuronte. Pas vdekjes së babait ai e la shkollimin dhe nuk shkoi më tej klasës së katërt. Më vonë familja u shpërngul në qytetin Linz dhe Adolf i ri lexonte me etje të madhe çdo libër që i binte në dorë. Pas një kohe e bëri mik të afërt studentin e muzikës, August Kubizek, i cili tregonte se kur ata rrinin bashkë, Hitleri i ri i mbante atij fjalime të zjarra në të cilat i mburrej për lavdinë e vet të ardhmes artistike, duke përjashtuar çdo shenjë ambicieje politike.

Në vjeshtën e vitit 1907, i riu Adolf, i cili sapo kishte mbushur 18 vjeç, me bekimin e nënës, mori vendimin që të shkonte në Vjenë për të hyrë në Akademinë e Arteve të bukura. Nuk arriti të regjistrohej, ndërkohë që në të njëjtin vit i vdes nëna, për vdekjen e të cilës kishte përjetuar pikëllim të thellë. Madje, mjeku personal i nënës së tij, doktori Bloch, duke analizuar shkallën e këtij pikëllimi, shumë më vonë kishte deklaruar se, për tu motivuar që ti sillte njerëzimit aq shumë fatkeqësi, Hitleri duhej të kishte një gjen shkatërrimtar që nuk shpjegohet dot. (Vijon)



ShSKUK-ja: Për nëntë muaj 335 raste me kancer të gjirit

PRISHTINË, 14 TETOR - Klinika e Onkologjisë e Qendrës Klinike dhe Universitare të Kosovës (QKUK) ka trajtuar 335 raste me kancer të gjirit gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2024, prej të cilave 332 janë gra dhe tre burra, apo 22 % të rasteve të sëmundjeve malinje të regjistruara deri në muajin shtator.

Një aspekt pozitiv është se 52 % e rasteve janë diagnostikuar në fazën e

hershme (stadet I dhe II), që tregojnë për ndërgjegjësimin në rritje ndaj kancerit të gjirit në Kosovë. “Të gjithë pacientet janë trajtuar në Klinikën e Onkologjisë sipas protokolleve ndërkombëtare, me barna; si citostatikë, terapi biologjike, hormonale, terapi të mençur, dhe radioterapi me teknika si IMRT dhe C-RAD. Trajtimi përfshin fazat neoadjuvante (lloj i trajtimit që jepet para

operacionit, zvogëlon tumorin), adjuvante (trajtimi pas ndërhyrjes kryesore, si operacioni për ta ulur rrezikun e rikthimit të kancerit). Si dhe metastatike, (kancer që përfshin dhe pjesë të tjera, i shpërndarë). Klinika e Onkologjisë ofron shërbime pa lista pritjeje për onkologji dhe radioterapi si dhe nuk ka referime për trajtim jashtë vendit”, ka njoftuar ShSKUK-ja.



Kosova u ofron mbrojtje të përkohshme 68 afganëve

PRISHTINË, 14 TETOR - Ministri i Brendshëm i Kosovës, Xhelal Sveçla, ka bërë me dije se të dielën Kosova u ka ofruar mbrojtje të përkohshme 68 afganëve.

Sveçla ka thënë në “Facebook” se akomodimi i tyre është vazhdimësi e angazhimit të Qeverisë së Kosovës ndaj krizës në Afganistan për t’i mbrojtur individët në rrezik nga konfliktet e brendshme.

Në mbledhjen e qeverisë, të mbajtur më 11 shtator, ishte miratuar vendimi për ofrim të mbrojtjes së përkohshme të 15 afganëve dhe familjarëve të tyre. Kjo nuk është hera e parë që Kosova strehon afganë në territorin e vet.

Në verën e vitit 2021, kur talibanët janë rikthyer në pushtet në Afganistan, dhe janë tërhequr forcat ndërkombëtare, Kosova pati pranuar kërkesën e Shteteve të Bashkuara për pranim të përkohshëm të rreth 1 900

afganëve.

Ata ishte paraparë të qëndronin në Kosovë derisa do ta kalonin procesin e verifikimit për t’u zhvendosur në ShBA, ose në ndonjë vend tjetër perëndimor.

ShBA-ja pati arritur marrëveshje të ngjashme edhe me disa vende të tjera, përfshirë Shqipërinë.

Autoritetet e Kosovës dhe ato amerikane patën thënë muaj më parë për Radion Evropë e Lirë se vetëm rreth 30 afganë kanë mbetur në Kosovë, dhe që po shqyrtohen mundësi për zhvendosjen e tyre.

Fillimisht lëvizjet e tyre kanë qenë të kufizuara, por më pas është thënë se ata kanë mundur të qarkullojnë nëpër gjithë territorin.

Afganëve të larguar nga Afganistani konsiderohet se u rrezikohet jeta nga regjimi taliban për shkak të bashkëpunimit që kanë pasur me forcat perëndimore para vitit 2021.

Prej ardhjes së talibanëve në pushtet, qeverinë e të cilëve nuk e njih asnjë vend në botë, të drejtat e



njeriut dhe sidomos ato të grave janë përkeqësuar konsiderueshëm, vlerësojnë

organizatat ndërkombëtare. Grave u ndalohet të dalin në ambiente publike pa një

shoqëruar burrë u është ndaluar shkollimi pas klasës së gjashtë dhe ushtrimi i një morie profesioneve.

IKShPK-ja: Uji i Badovcit ende i papijshëm, vazhdon prania e manganit



PRISHTINË, 14 TETOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka vazhduar monitorimin e ujit për pije që furnizohet nga Ujësjellësi Rajonal KRU “Prishtina” nga Liqeni i Badovcit.

Gjatë analizave të fundit janë vërejtur ulje të vlerave të manganit, por këto vlera ende qëndrojnë mbi limitet e lejuara sipas Udhëzimit Administrativ nr. 10/2021 “Për cilësinë e ujit të destinuar për konsum nga njeriu”. “IKShPK thekson se ndotja me mangan është një ndotje kimike, dhe vlimi i ujit nuk e eliminon manganin, siç ndodh me ndotjen

bakteriologjike”, thuhet në njoftim.

Si rezultat, uji aktualisht është i papërshtatshëm për konsum. Ekipe të IKShPK-së do të vazhdojnë ta monitorojnë situatën e ujit të pijshëm nga Liqeni i Badovcit edhe në ditët në vijim, duke bashkëpunuar ngushtë me KRU “Prishtina” për stabilizimin e gjendjes së krijuar për shkak të “fenomenit” të manganit.

Përdoruesit e ujit nga kjo zonë janë të inkurajuar të jenë të kujdesshëm dhe t’i ndjekin udhëzimet e autoriteteve për përdorimin e ujit të pijshëm.

Mbi 7 000 mijë kërkesa për regjistrim për votim jashtë vendit

Prishtinë, 14 tetor - Deri më 13 tetor të këtij viti në platformën elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve janë pranuar mbi 7 200 kërkesa për regjistrim për votim jashtë vendit, prej

të cilave janë aprovuar mbi 6 600, ndërsa 593 të tjera janë refuzuar.

Në mbledhjen e KQZ-së të hënën, drejtori i Zyrës për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të

Subjekteve Politike, Besnik Buzhala, ka thënë se në shumicën e rasteve të refuzuara, aplikuesit nuk janë fotografuar, duke mbajtur njëkohësisht në dorë dokumentin e identifikimit.

Ndërsa për ndërrimin e Qendrës së Votimit brenda komunës deri më tani janë pranuar 892 kërkesa për ndërrim të qendrës.

Buzhala ka shtuar se prej tyre janë aprovuar 866 kërkesa,



ndërsa 26 të tjera janë refuzuar.

BE-ja pran finalizimit të mjeteve për Ballkanin Perëndimor

PRISHTINË, 14 TETOR - Bashkimi Evropian është shumë afër t'i përmbyllë procedurat e miratimit të agjendave të reformave të cilat i kanë paraqitur vendet e Ballkanit Perëndimor si kusht për të përfituar nga paketa e Planit të Rritjes në vlerë prej 6 miliardë eurosh.

Përfituese të Planit - që u miratua nga BE-ja në maj - janë të gjitha vendet e rajonit: Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Bosnjë-Hercegovina dhe Serbia.

Komisioni i IPA-s (Instrumentet e Para-Anëtarësimit) dha më 11 tetor pëlqimin final për vetëm pesë nga gjashtë vendet që i kanë paraqitur agjendat e reformave dhe rritjes.

I vetmi vend i rajonit, i cili nuk mund të presë ende miratimin e agjendës së tij, është Bosnjë-Hercegovina, pasi që dokumenti që ky vend e ka dërguar në BE, nuk ka qenë komplet dhe nuk i ka adresuar të gjitha sugjerimet e dhëna nga Komisioni Evropian.

Komisioni Evropian pritet që më 16 tetor ta miratojë vendimin për zbatim.

Në këtë mënyrë Komisioni Evropian do të jetë i gatshëm t'i kryejë edhe pagesat e para nga paketa në fjalë. Por, para se të bëhen këto pagesa, vendet përfituese duhet t'i nënshkruajnë marrëveshjet dhe t'i ratifikojnë ato në parlamentet e tyre kombëtare, sepse dy miliardë euro do të jenë para pa kthim, ndërsa të tjerat do të jenë kredi të favorshme.

Ndaj vendet përfituese duhet t'i ratifikojnë marrëveshjet, pasi që duhet të obligohen për kthimin e

parave nga kreditë e favorshme. Për shkak të procedurave që kërkojnë kohë për miratimin e marrëveshjeve të tilla, është vështirë të parashihet koha se kur do të bëhen pagesat e para dhe për cilin vend të rajonit.

Realisht ato mund të bëhen në fillim të vitit 2025, por nëse ndonjë vend nxiton dhe e kryen më herët procedurën e ratifikimit të marrëveshjeve, atëherë këto mjete do të mund të paguhen më herët.

Ideja e BE-së është që të gjitha vendeve, për të cilat do të aprohen agjendat e reformave dhe rritjes, t'u ndahet si "pagesë parafinancuese" shuma prej 7% e mjeteve të dedikuara për to. Me këtë paketë, BE-ja synon ta ndihmojë rritjen ekonomike në vendet e rajonit dhe, në këtë mënyrë, ta përshpejtojë procesin e integritit të tyre evropian.

Sipas një përlogaritje jozyrtare, Kosova do të mund të përfitojë mbi 880 milionë euro nga ky plan i rritjes.

Mbi 250 milionë euro Kosovës do t'i ndaheshin si para pa kthim, ndërsa pjesa tjetër në formën e kredive të volitshme.

Rrjedhimisht, Kosovës do t'i paguheshin 7% e mjeteve si "parafinancim", që i bie rreth 61 milionë euro.

Shqipëria do të mund të përfitojë në total 922 milionë euro, ndërsa si mjete "parafinancuese" 64.5 milionë.

Maqedonia e Veriut do të mund të ketë në dispozicion 750 milionë euro, ndërsa pagesa e parë për të do të ishte 52.5 milionë.

Serbisë do t'i ndaheshin gjithsej



1.58 miliard euro, ndërsa pagesa e parë për të do të ishte 111 milionë. Mali i Zi do të kishte në dispozicion gjithsej 383 milionë euro, ndërsa si "parafinancim" 26.8 milionë.

Bosnjë-Hercegovina, nga totali i planit, do të kishte në dispozicion 1 miliard e 85 milionë euro, ndërsa si "parafinancim" 76 milionë.

Llogaritja se cili vend do të ketë në dispozicion sa mjete financiare është bërë në bazë të Bruto Prodhimit Vendor (GDP), numrit të banorëve dhe disa kriterëve të tjera.

Por, që në prezantimin e parë të këtij plani, më herët këtë vit, vendeve të rajonit u është thënë qartë se nëse ndonjëri nuk i kryen reformat pas një-dy vjetësh, atëherë shuma e dedikuar për të do t'u shpërndahet vendeve të

tjera. Plani, po ashtu, ka qëllim ta nxisë bashkëpunimin rajonal dhe zhvillimin e tregut të përbashkët në rajon, i cili gradualisht do të integrohet në tregun e përbashkët të Bashkimit Evropian.

Ky plan, sipas zyrtarëve të BE-së, nuk ka në asnjë mënyrë qëllim të krijojë ndonjë alternativë të zgjerimit të BE-së, por ta bëjë anëtarësimin në BE të këtyre vendeve më të lehtë.

Bashkimi Evropian do që pagesat e para nga ky plan të kryhen sa më parë dhe të nisë zbatimin e projekteve që do të financoheshin përmes tyre.

Në të njëjtën kohë në BE rikujtojnë edhe kushtet që duhet të përmbushen gjatë gjithë procesit të realizimit të projekteve. Ato kanë të bëjnë me sundimin e ligjit,

kontrollin financiar dhe auditimin e duhur sipas standardeve evropiane, ndërsa në rastin e Kosovës dhe të Serbisë, kusht specifik është edhe angazhimi konstruktiv në normalizimin e raporteve mes tyre.

Në rast të keqpërdorimit të këtyre mjeteve, BE-ja do të mund ta kërkojë kthimin e tyre, ndërsa mjetet e pashfrytëzuara nga ndonjë vend, do të mund të shfrytëzoheshin për një vend tjetër të rajonit.

Deri më tash ky është plani më ambicioz i veçantë i Bashkimit Evropian për vendet e rajonit, i cili nuk është pjesë e mjeteve të rëndomta nga Instrumentet e Para-Anëtarësimit (IPA), të cilat u dedikohen vendeve nga procesi i zgjerimit, përfshirë edhe ato të Ballkanit Perëndimor.

ASK-ja: Pagat mesatare bruto në Kosovë më 2023 ishin 570 euro

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 14 TETOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar "Nivelin e pagave në Kosovë" për vitin 2023. Ky publikim përmban të dhëna për pagën mesatare bruto dhe neto sipas sektorëve dhe aktiviteteve ekonomike në sektorin publik (administrata), ndërmarrjet publike dhe sektorin privat në Kosovë.

Në vitin 2023 pagat mesatare bruto në Kosovë ishin 570 euro, derisa në vitin 2022 ishin 521 euro. Pra, kishte rritje prej 49 eurosh nga viti paraprak, kurse paga neto në vitin 2023 ishte 506 euro, krahasuar me vitin 2022 që ishte 446 euro. Pra, një rritje prej 60 eurosh.

Paga mesatare bruto në sektorin privat në vitin 2023 ishte 515 euro, derisa në vitin 2022 ishte 473 euro. Pra, kishte një rritje prej 42 eurosh, ndërsa paga mesatare neto ishte 459 euro, krahasuar me vitin 2022



e cila ishte 401 euro. Pra, një rritje prej 58 eurosh.

Te sektori publik vërehet një rritje e konsiderueshme e pagës për rreth 18% krahasuar me vitin paraprak, dhe kjo rritje ka ardhur si rezultat i hyrjes në fuqi të Ligjit

për Pagat në sektorin publik (Ligji nr. 08/L-19) nga muaji janar 2023. Paga mesatare bruto në sektorin publik në vitin 2020 ishte 624 euro, derisa në vitin 2023 ishte 713 euro, duke u rritur për 89 euro, ose 14.2%. Ndërsa paga mesatare neto nga

552 euro, sa ishte në vitin 2020, u rrit në 630 euro në vitin 2023. Një rritje prej 78 eurosh, ose 14.1%. Paga mesatare bruto në sektorin e ndërmarrjeve publike në vitin 2020 ishte 769 euro, derisa në vitin 2023 ishte 789 euro. Një rritje prej

20 eurosh ose 2.6%, ndërsa paga mesatare neto nga 680 euro, sa ishte në vitin 2020, u rrit në 691 euro në vitin 2023. Një rritje prej 11 eurosh, ose 1.6%.

Niveli i pagave më të larta në Kosovë ishte sektori i ndërmarrjeve publike, derisa me paga më të ulëta ishte sektori privat.

Paga mesatare bruto në vitin 2023, sipas aktiviteteve ekonomike, më e larta ishte te: Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar (1039 euro); dhe informim dhe komunikimi (974 euro). Derisa paga më e ulët ishte te akomodimi dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim (345 euro).

Paga mesatare neto në vitin 2023, sipas aktiviteteve ekonomike, ka të njëjtën renditje si më poshtë: Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar (870 euro); informim dhe komunikimi (850 euro); akomodimi dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim (312 euro).

Politikat e jashtme të ShBA-së dhe Evropës për shqiptarët në përgjithësi, Kosovën dhe çështjen e saj



Shkruan:
Prof. Dr. Fejzulla BERISHA

Çështja shqiptare, duke përfshirë Shqipërinë, Kosovën dhe shqiptarët në rajon, ka qenë një pikë kyçe në politikën ndërkombëtare, veçanërisht në marrëdhëniet me administratat amerikane dhe evropiane. Për të ilustruar më qartë dhe me konkretësi, do të shqyrtojmë disa periudha të rëndësishme historike dhe aktuale, duke theksuar ngjarjet kryesore dhe rolin e këtyre administratave. Pas Luftës së Parë Botërore, çështja e Shqipërisë u përfshi në agjendën e Konferencës së Paqes në Paris (1919), ku disa vende, si Serbia dhe Greqia, kërkuan copëtimin e Shqipërisë. Shqiptarët ndodheshin në një pozicion të pafavorshëm, pasi fuqitë e mëdha nuk e konsideronin vendin si një entitet të qëndrueshëm. Megjithatë, Presidenti amerikan Woodrow Wilson kundërshtoi fuqimisht këto përpjekje dhe mbrojti të drejtën e Shqipërisë për ekzistencë si një shtet i pavarur. Wilson, duke u bazuar në parimin e vetëvendosjes së popujve, deklaroi: "Shqipëria nuk duhet të sakrifkohet për qëllimet territoriale të fqinjëve të saj." Kjo ndërhyrje diplomatike bëri që Shqipëria të ruante tërësinë e saj territoriale, edhe pse u përball me kufizime dhe sfida të tjera politike.

Gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë, Shqipëria u bë një nga shtetet më të izoluar në Evropë, nën regjimin e Enver Hoxhës. Marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara dhe vendet evropiane u shkëputën plotësisht për shkak të lidhjeve me Bashkimin Sovjetik dhe Kinën. Administrata amerikane, gjatë kësaj periudhe, shikonte Shqipërinë si një bastion të komunizmit në Ballkan, dhe nuk kishte marrëdhënie të ngushta me të, përveç përpjekjeve të disidentëve shqiptarë për të krijuar kontakte të fshehta për rrëzimin e regjimit. Nga ana tjetër, Evropa Perëndimore, përfshirë vendet si Italia dhe Greqia, qëndronin të distancuara nga Shqipëria për shkak të politikave të saj të mbyllura.

Një nga shembujt më të qartë të ndërhyrjes amerikane dhe evropiane në çështjen shqiptare është Lufta e Kosovës. Pas

shpërbërjes së Jugosllavisë dhe rritjes së represionit ndaj shqiptarëve të Kosovës, ShBA-ja dhe vendet kryesore të BE-së, si Gjermania, Britania e Madhe dhe Franca, u angazhuan në mbrojtjen e shqiptarëve. Në mars të vitit 1999, pasi përpjekjet diplomatike për paqe dështuan në Rambuje, NATO ndërmoi një ndërhyrje ushtarake kundër forcave serbe të udhëhequra nga Slobodan Milosheviqi. Ky operacion, i udhëhequr nga ShBA dhe me mbështetjen e fuqishme të vendeve evropiane, rezultoi në çlirimin e Kosovës dhe vendosjen e administratës ndërkombëtare. Ky ishte një moment historik për shqiptarët, ku administrata e Presidentit Bill Clinton dhe ndërhyrja e NATO-s shpëtuan shqiptarët nga pastrimi etnik dhe ndihmuan në krijimin e një rruge drejt pavarësisë.

Më 17 shkurt 2008, Kosova shpalli pavarësinë nga Serbia, një ngjarje e rëndësishme në kontekstin e çështjes shqiptare në rajon. Kjo pavarësi u njoh menjëherë nga Shtetet e Bashkuara dhe shumica e vendeve kryesore të BE-së, përfshirë Gjermaninë, Francën, Britaninë e Madhe dhe Italinë. Administrata e Presidentit George W. Bush luajti një rol vendimtar në mbështetjen e pavarësisë së Kosovës, duke e konsideruar atë si të drejtën legjitime të popullit të Kosovës për vetëvendosje. ShBA-ja gjithashtu kontribuoi në krijimin e institucioneve të reja të shtetit të Kosovës dhe vazhdon të jetë mbështetësi kryesor i stabilitetit dhe integritetit të saj.

Nga ana tjetër, Bashkimi Evropian ka pasur një qasje më të ndërlikuar. Shumica e vendeve të BE-së e kanë njohur Kosovën, por disa vende anëtare, si Spanja, Rumania, Greqia, Sllovakia dhe Qiproja, ende refuzojnë ta njohin për shkak të shqetësimeve të tyre të brendshme për lëvizjet separatiste. Megjithatë, BE-ja ka lehtësuar dialogun midis Kosovës dhe Serbisë, duke synuar normalizimin e marrëdhënieve midis tyre dhe integrimin e tyre në strukturat evropiane.

Shqipëria u bë anëtare e NATO-s në vitin 2009, një ngjarje e rëndësishme për të ardhmen e stabilitetit në rajon. ShBA-ja dhe vendet evropiane luajtën një rol kyç në sigurimin e reformave të nevojshme për Shqipërinë që t'i bashkohej aleancës.

Kosova, megjithëse nuk është ende anëtare e NATO-s për shkak të çështjeve të pazgjidhura me Serbinë, ka marrë një mbështetje të fortë nga ShBA dhe vende të tjera për integrimin e saj të mëtejshëm në strukturat ndërkombëtare. BE-ja ka përsheptuar integrimin e Kosovës në kuadrin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, duke e ndihmuar të

zhvillojë institucionet demokratike. Një çështje shumë e rëndësishme aktuale është dialogu midis Kosovës dhe Serbisë, që udhëhiqet nga Bashkimi Evropian, por ku ShBA-ja ka një ndikim të rëndësishëm. Qëllimi kryesor i këtij dialogu është arritja e një marrëveshjeje të qëndrueshme për normalizimin e marrëdhënieve, që do të ndihmonte Kosovën të integrohej plotësisht në komunitetin ndërkombëtar dhe BE.

Administrata e presidentit Donald Trump ndërmoi një nismë të veçantë në vitin 2020 për të sjell Kosovën dhe Serbinë në një marrëveshjeje për normalizimin ekonomik, ndërsa administrata e presidentit Joe Biden ka ripërsëritur përkushtimin për arritjen e një marrëveshjeje politike që do të çonte në njohjen

reciproke.

Çështja shqiptare ka qenë një prioritet në politikën e jashtme amerikane dhe evropiane, sidomos në periudhat kyçe të historisë. Nga mbrojtja e pavarësisë së Shqipërisë nga Wilsoni, te ndërhyrja e NATO-s në Kosovë, dhe deri te përpjekjet aktuale për integrimin e Kosovës dhe Shqipërisë në BE dhe NATO, administratat amerikane dhe evropiane kanë luajtur një rol të pazëvendësueshëm në përcaktimin e të ardhmes së shqiptarëve në Ballkan.

Politika amerikane ndaj Kosovës ka qenë historikisht mjaft konsistente, pavarësisht se cili parti ka qenë në pushtet, demokratët apo republikanët. ShBA-ja ka mbështetur fuqimisht pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës që nga shpallja e saj e

pavarësisë më 2008. Edhe gjatë administratave të ndryshme, qasja amerikane ka theksuar mbështetjen për stabilitetin në Ballkanin Perëndimor, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Në zgjedhjet e 2024-s, pavarësisht se kush do të fitojë këto zgjedhje, demokratët apo republikanët, është pak e mundshme të ketë ndryshime të mëdha në këtë politikë. Të dyja partitë zakonisht ndajnë qëndrimin e njëjtë për çështjet e sigurisë dhe stabilitetit në Ballkan, përfshirë përpjekjet për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë përmes dialogut të lehtësuar nga BE-ja dhe mbështetjen për përpjekjet euro-atlantike të rajonit.



Ish-Presidenti amerikan Woodrow Wilson

Mick Schumacheri pran rikthimit në Formula 1

MUNCHEN, 14 TETOR - Për sezonin 2025 në Formula 1 ka mbetur për t'u përcaktuar vetëm një pilot. Bëhet fjalë për pilotin e dytë të skuadrës Kick Sauber, shokun e skuadrës së Nico Hulkenberg. Deri pak javë më parë Valtteri Bottas ishte në "pole position", por performancat e tij të fundit

dhe, mbi të gjitha, kërkesat financiare të finlandezit kanë bërë që drejtuesit e lartë të Audisë ta rishikojnë këtë pozicion. Për pasojë, Audi po merr "në konsideratë serioze" rikthimin e Mick Schumacherit. Edhe Mattia Binotto, kreu i kompanisë gjermane për projektin në F1, ka

pranuar se kjo hipotezë është realiste për vitin 2025. "Nuk do të nxitohemi, por sigurisht që po konsiderojmë Mick Schumacher. E takova dhe fola me të, e njoh prej disa kohësh pasi ka qenë pjesë e Akademisë së Ferrarit. Unë i di meritat dhe avantazhet e tij. Ai është një nga emrat që kemi

në mendje", ka thënë Binotto. Gjithsesi, ka një radhë të madhe konkurrentësh për një vend në Kick Sauber. Nuk janë vetëm Bottas dhe Schumacher, por edhe Gabriel Bortoletto, Theo Pourchaire dhe Franco Colapinto, që aktualisht garon me Williamsin.



Gjyqtarët e Superligës dhe Ligës së Parë përfundojnë me sukses testimet fizike

PRISHTINË, 14 TETOR - Pasi kampionati vendor në dy nivelet më të larta, Albi Mall Superligë dhe Raiffeisen Ligën e Parë, u ndaluan për shkak të angazhimeve ndërkombëtare të ekipeve kombëtare, gjyqtarët e këtyre kategorive iu nënshtuan testeve fizike të radhës në Kampin Nacional në Hajvali. Ky ishte testimi i dytë për këtë sezon, pas atij të mbajtur para fillimit të kampionatit, me qëllim që gjyqtarët të jenë në formë sa më të mirë për sfidat që i presin në vazhdimin e kampionatit. Testet fizike u mbajtën nën mbikëqyrjen e Komisionit të Gjyqtarëve, në krye me Përparim Hasanin. Në këtë proces u vlerësua gjendja fizike dhe gatishmëria e gjyqtarëve për t'i përballuar kërkesat e larta që sjellin ndeshjet e kampionatit. Gjyqtarët treguan përkushtim dhe seriozitet maksimal në përmbushjen e këtyre testeve,



duke dëshmuar formë të lartë dhe përgatitje profesionale. Përparim Hasani, kryetar i Komisionit të Gjyqtarëve, vlerësoi lart punën dhe përkushtimin e gjyqtarëve, duke theksuar rëndësinë e mbajtjes së formës fizike dhe nivelit të kondicionit gjatë gjithë

sezonit. Ai u shpreh se këto teste janë pjesë e një plani më të gjerë për të siguruar që gjyqtarët të jenë gjithmonë të përgatitur për ndeshjet e kampionatit, duke respektuar standardet ndërkombëtare të vendosura nga FIFA dhe UEFA.

Ish-numri 1 i botës në altar, martohet me tifozin që i uroi 'fat të mbarë' në park gjatë US Open

MADRID, 14 TETOR - Ish-tenistja spanjolle Garbine Muguruza, e tërhequr nga sporti vetëm pak muaj më parë, kur ishte 31 vjeçe, i ka thënë "po" njeriut të saj të zemrës. Fundjavën e kaluar ajo është martuar me Arthur Borges, një fans i saj. Takimi i parë mes të dyve ishte krejtësisht i rastësishëm: Ata u takuan rastësisht në Central Park dhe gjithçka nisi nga një "fat të mbarë" që ai i tha tenistes. Që atëherë ata nuk e kanë lënë kurrë njëri-tjetrin dhe tashmë janë martuar. Muguruza, fituese e dy grand slameve në karrierën e saj dhe ish-numri 1 në botë në vitin 2017, ka publikuar në profilin e saj në "Instagram" foto të ditës së madhe, në të cilat të dy bashkëshortët shfaqen të lumtur dhe të emocionuar për hapin e madh. Vetëm prillin e kaluar ajo vendosi të tërhiqej nga loja e tenisit, duke "varur raketën e saj në gozhdë". Gjithsesi, ajo u bë drejtoreshë e finaleve të WTA, që do të luhen në Riad të Arabisë Saudite deri në vitin 2026. Çifti u martua në Marbella,



para 90 të ftuarve nga e gjithë bota. Mes të ftuarve ishin edhe Carla Suarez Navarro, ish-partnerja e saj në dyshe dhe Conchita Martinez, trajnerja e saj e ikona të tenisit spanjoll. Garbine Muguruza u takua rastësisht me burrin e saj të ardhshëm, me rastin e US Open 2021. "Hoteli im ishte afër Central Park dhe unë u merrza, kështu që mendova të shkoja për një shëtitje. Unë dal dhe e takoj në rrugë. Papritmas ai kthehet dhe më thotë: 'Paç fat në US Open'. Mendova: 'Uau, është shumë e bukur'. Pas

propozimit për martesë, tenistja tha: "E dija se do të martohesha me të edhe para se të më kërkonte. Kur u njohëm ishte dashuri me shikim të parë dhe menjëherë kuptuam që ishim një çift ideal". Arthur Borges është një model dhe sipërmarrës spanjoll 40-vjeçar: ai ka jetuar pjesën më të madhe të jetës së tij në Finlandë dhe ka një diplomë në administrim biznesi. Nuk është martesë e parë për të, duke qenë se në të kaluarën ka qenë i martuar me ish-patinatoren artistike finlandeze Kiira Korpi.

SHKURT

Interi i shtohet garës për Ismajlin

Mes shumë objektivave të ardhshëm të merkatos së Interit ka përfunduar së fundmi edhe Ardjan Ismajli, si një zëvendësues i mundshëm i Acerbit dhe De Vrij, të cilët mund të largohen në fundin e sezonit. Shumë emra janë përmendur në perspektivë, mes mundësive me kosto të ulët dhe goditjeve prospektive, por klubi milanez do ta ketë të vështirë të operojë, duke qenë se nuk është i vetmi ekip që do të duhet ta rregullojë mbrojtjen në verën e ardhshme. Sipas "calcermarcato.it", Ismajli ka befasuar pozitivisht në javët e para të këtij sezoni. Juventusit prej disa ditësh ka shfaqur interesim për mbrojtësin e Kombëtares kuqezi, madje dërgoi edhe skaut për ta vëzhguar në Pragë, për duelin kundër Çekisë. Ai shihet si zëvendësuesi ideal i Bremerit në merkaton e dimrit, por mesa duket do të duhet ta mposhtë rivalitetin e Interit. Ismajli ka kontratë deri në vitin 2025 dhe është në diskutime për rinovimin e kontratës.

Trepça regjistron fitore në Prizren

Trepça u rikthye te fitoret, duke mundur në udhëtim Proton Cable Prizrenin me shifrat 68:89 (14:22, 14:30, 18:13, 22:24), në javën e pestë të ProCredit Superligës. Mitrovicasit e nisën ndeshjen më mirë, duke pasur epërsi konstante në çerekun e parë, që e fituan 14:22, derisa me lojë të mirë vazhduan edhe në periudhën e dytë, që e fituan 14:30, për të shkuar në pushim me rezultat 28:52. Në pjesën e dytë, "Xehetarët" menaxhuan epërsinë për të shkuar drejt fitores dhe përkundër tentimeve nga vendasit, arritën synimin për të triumfuar 68:89. Te vendasit u dallua Jordan Johnson me 21 pikë, pesë kërcime e tetë asistime, kurse te mysafirët u dalluan Desmond Cambridge me 20 pikë e katër kërcime dhe Malik Johnson me 20 pikë, pesë kërcime e shtatë asistime. Proton Cable Prizreni ka një fitore e katër humbje, derisa Trepça numëron tri fitore e dy humbje.

Guardiola mohon marrëveshjen me Kombëtaren e Anglisë

Pep Guardiola ka refuzuar thashethemet që e lidhnin atë me mundësinë për t'u bërë përzgjedhës i Anglisë në vitin 2025. E ardhmja e Guardiolas te Manchester City mbetet në dyshim pasi kontrata e tij me kampionin në fuqi të Ligës Premierë skadon në fund të sezonit. Klubi është i etur që ish-trajneri i Barcelonës të rinovojë me ta, por Guardiola ende nuk e ka marrë vendimin përfundimtar. Përkundër raportimeve paraprake se një vendim do të merrej para fundit të vitit 2024, kjo çështje duket se do të zgjatet deri në vitin 2025. Përzgjedhësi i përkohshëm Lee Carsley e ka distancuar veten për ta marrë përfundimisht drejtimin e Anglisë teksa ai është në krye të "Tre Luanëve" vetëm për ndeshjet e Ligës së Kombeve. Eddie Howe dhe Thomas Tuchel janë nën konsideratë për ta udhëhequr Anglinë, por Guardiola është "kandidati i ëndrrave" nëse vendos të largohet nga City. Guardiola e ka mohuar se është arritur ndonjë marrëveshje dhe se nuk është duke konsideruar ndonjë ofertë për momentin pasi fokusi i tij është vetëm te City. "Jo, këto thashetheme nuk janë të vërteta. Nëse kam vendosur diçka do të thosha jo. Mund të bëj gjithçka", ka thënë Guardiola për Che Tempo, Che Fa.

Haalandi në të ardhmen dëshiron të transferohet në Spanjë

Erling Haaland thuhet se ka vendosur të largohet nga Anglia, me të ardhmen e tij që pritet të jetë në Spanjë. Sulmuesi e ka bërë të qartë se dëshiron një sfidë të re, duke tërhequr interes nga gjigantët

e La Ligas, Real Madrid dhe Barcelona. Të dy klubet janë të prira për ta siguruar nënshkrimin e Haalandit. Real Madridi e sheh norvegjezin si një partner perfekt për Kylian

Mbappen dhe është i përgatitur të investojë shumë për ta sjellë atë. Barcelona është gjithashtu në përzierje, pavarësisht prej vështirësive të saj financiare. Klubi beson se Haalandi mund të jetë

lojtari kryesor për ta udhëhequr sulmin e tyre në të ardhmen. Drejtori sportiv Deco po monitoron nga afër situatën e Haalandit dhe është gati t'i shqyrtojë opsionet për të realizuar këtë lëvizje.

Vendimi i Haalandit do të varet nga apelimi i projektit të çdo klubi dhe aftësia e tyre për t'i përmbushur kërkesat e tij. Ndërsa situata zhvillohet, Madridi dhe Barcelona do të vazhdojnë ta ndjekin nga afër.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Gjithëçka Beni” Sh.P.K. me seli në Gjilan, me pronar Ramize Ibrahimimi dhe Egzona Mahmuti, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811485061 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Gjithëçka Beni” D.O.O. od Gnjilane, sa vlasnikom Ramize Ibrahimimi i Egzona Mahmuti donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811485061 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Gjithëçka Beni” L.L.C. with headquarters Gjilan, owner Ramize Ibrahimimi and Egzona Mahmuti has come to the decision to quit its business: 811485061 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “R50kt” Prishtinë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për parkun e energjisë diellore në Ramjan komuna e Vitisë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 02.12.2024 në ora 10:00 në "Shtëpinë e Kulturës - Salla e Kuvendit", komuna e Vitisë do të organizohet debat publik nga Kompania “R50kt” Prishtinë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us05web.zoom.us/j/83802849711?pwd=Ty54jwBEDila6GJwk25KgCszQodDXy.1>

Passcode
123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “R50kt” Prishtinë për parkun e energjisë diellore në Ramjan komuna e Vitisë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejite

RESTAURANT**SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Zenel Mehmeti B.I. me emrin tregtar N.T.P. “Zeneli-M” shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 811097311.

- Hil Quni nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi”, Gjakovë.

- Hanife Brahimi, shpall të pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën e SHMLM “Xheladin Deda”.

- Gresa Spahija nga Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesat e klasës; 10, 11, 12 dhe diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë “Hysni Zajmi”, Gjakovë.

- Sebahate Zena, shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Azem Bejta” DUBOC.

Asociacioni i Arkitektëve të Kosovës shpall të pavlefshme certifikatën e numrit fiskal me nr. 600207379.

- Adriana Haxhiu, shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e SHMLE “Hasan Prishtina”.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Doruntina Demjaha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës; 10, 12 të shkollës së mesëm të mjekësisë “Hysni Zajmi”, Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Drenis Demjaha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës; 10, 11, 12 të shkollës së mesme të mjekësisë “Hysni Zajmi”, Gjakovë.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Alban Islamaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme SH.M.L.T “Hysni Zajmi”, Gjakovë.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Arti Maka nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës 10, 11, 12 dhe diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë “Hysni Zajmi”, Gjakovë.

U bënë 16 vjet nga ndarja e më të dashurit tonë



Milaim H. Misini

(23.04.1938 - 13.10.2008)

Vdekja të ndau nga Jeta, por jo nga zemrat tona.
E përkujtojnë Familja Misini nga Prishtina dhe Korretica e Ulët.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

